



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 677/7 prot.

Tiranë, më 22.09.2021

**VENDIM**

**Nr. 109, datë 22.09.2021**

**PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 104, DATË 07.09.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 104, datë 07.09.2021, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e statusit të nëpunësit civil, \*\*\*\*\* , aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”*.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës, protokolluar me nr. 398 prot, datë 09.03.2021, paraqitur nga Bashkia Kamëz, është ngritur pretendimi se në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, \*\*\*\*\* , aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, *“Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”* në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, vazhdon të jetë i emëruar me kontratë me afat të caktuar, ndërkohë, që duhet të ishte pjesë e shërbimit civil, dhe si i tillë ky pozicion duhej të plotësohej vetëm nëpërmjet kryerjes së procedurës së konkurrimit, parashikuar nga nenet 21 deri 24, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Kamëz të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përbyllur me Vendimin nr. 104, datë 07.09.2021, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e statusit të nëpunësit civil, \*\*\*\*\*, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”.*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Kamëz ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.104, datë 07.09.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Bashkia Kamëz të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësin \*\*\*\*\*, si dhe të shpallë menjëherë pozicionin të lirë, për plotësimin e tij sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 104, datë 07.09.2021, Bashkia Kamëz me urdhrin nr.450, datë 09.09.2021, ka ndërprerë marrëdhënien e punës për punonjësin \*\*\*\*\*.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 104, datë 07.09.2021, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e statusit të nëpunësit civil, \*\*\*\*\*, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”.*

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Bashkisë Kamëz, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.104, datë 07.09.2021.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kamëz dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**